



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. **Prot.**
Nr. Dok. 201800546/2

Tiranë ___/___/2018

Lënda : *Rekomandohet marrja e masave ligjore për shpejtimin e gjykimit të çështjes administrative me Nr.31018-03936-86-2016 akti datë 22.07.2016, me paditës V. L., nga Tirana.*

Drejtuar : **Z.KASTRIOT SELITA**
Kryetar i Gjykatës Administrative të Apelit

TIRANË

Për dijëni : Z.Vangjel LIÇO
Rr."Ali Demi", Pallati Nr.261, Shk.2, Ap.14

TIRANË

I nderuar zoti Kryetar,

Në ankesën e saj datë 21.03.2018, drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit, shtetësja L. P., na shkruan se bashkëshorti i saj V. L., ka zhvilluar një gjykim me datë 16.06.2016, në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është vendosur pranimi i pjesshëm i padisë kundra D.R.S.SH Tiranë me objekt detyrimin për shqyrtimin e kërkesës së tij datë 04.10.2008, për të dalë në Kemp si invalid dhe për të përfituar pension suplementar si ushtarak.

Kundra këtij vendimi gjyqësor palët janë ankuar në shkallë të dytë në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, dhe dosja juaj tani ndodhet e regjistruar për gjykim në atë Gjykatë me Nr.31018-03936-86-2016 akti, datë 22.07.2016, dhe pasi është hedhur shorti elektronik si Relator i çështjes është caktuar Gjyqtari Bari SHYTI, i cili nga ana e tij nuk ka planifikuar akoma gjykimin e kësaj çështje.

Ankuesja L. P. nga ana e saj, na shkruan se bashkëshorti i saj V. L., është i sëmure dhe i pamundur nga ana shëndetësore që të interesohet dhe të presë pambarim gjykimin e kësaj çështje gjyqësore, prandaj me anën e kësaj ankese ajo ka kërkuar ndihmën brenda hapsirave ligjore, të bëhet shpejtimi i këtij gjykimi sa më shpejtë në të ardhmen.

Ankuesja nga ana e saj ka kërkuar gjithashtu nga Gjykata Administrative e Apelit Tiranë, të zhvillohet një gjykim i drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanëshme e caktuar me ligj. Në nenin 48/2 të Ligjit nr.49/2012 "Për Organizmin dhe Funksonimin e Gjykatave Administrative dhe gjykimi e mosmarrëveshjeve administrative parashikohet se:

"Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve, nga data e ardhjes së ankimit nga Gjykata ku është paraqitur ankimi".

Nga verifikimet e kryera nga ana jonë rezulton se dosja në fjalë ndodhet e rregjistruar për gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit me datën 22.07.2016, dhe akoma nga relatori i çështjes nuk është bërë planifikimi e gjykimit të saj ç'ka na detyron ne si institucion që të ndërhyhet me rekomandim për marrjen e masave për shpejtimin e saj.

Kështu në referim të kërkesave të nenit 63/3 të Kushtetutës së RSH ku përcaktohet se:

”Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekoamndime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të Njeriut, nga administrata publike”.

Po kështu duke u bazuar në kërkesat e nenit 21/b të Ligjit me Nr.8454 datë 04.02.1999”Për Avokatin e Popullit” thuhet se:

”Pas përfundimit të hetimit, Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrjen e masave për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi epror, i organit që ka shkaktuar shkeljen, dhe ne ju,

REKOMANDOJMË :

1.Marrjen e masave ligjore për planifikimin e gjykimit të çështjes administrative datë 22.07.2016, me paditës V. L., dhe si palë e Paditur : D.R.S.SH Tiranë me objekt shqyrtimin e kërkesës së paditësit për në Kemp datë 04.10.2008, për të përfituar pension suplementar si ushtarak.

2.Mbi masat e marra nga ana juaj, për zbatimin e këtij rekomandimi, lutemi të njoftohemi me shkrim brenda afatit 30 ditor.

Duke besuar në mirëkuptim dhe bashkëpunimin tuaj,

KOMISIONERI

Arben SHKËMBI